

**MANUALI I FUNKSIONIMIT DHE ROLEVE TË STRUKTURAVE
SHËNDETËSORE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE NË
QENDRAT
SHËNDETËSORE VERORE**

**“Kush ka shëndet, ka shpresë dhe kush ka
shpresë, ka gjithçka.”**

www.oshksh.gov.al





MIRËSEERDHËT

NË EKIPIN E OPERATORIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR



Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor u krijua në vitin 2018 me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 4.7.2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”.


Institucioni u krijua në vazhden e logjikës së simotrave të veta europiane që shpesh njihen si shërbime kombëtar shëndetësore (national health services). Fillimisht OSHKSH (Operatori në vijim) filloi të funksiononte pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, derisa arriti të ravijëzonte strukturën e vet të qëndrueshme që shtrihet edhe në territor.

Operatori sot ka në varësi, monitorim e mbikëqyrje drejtoritë e veta rajonale, njësitë e veta vendore, qendrat shëndetësore dhe spitalet bashkiakë e rajonalë.



BAZA LIGJORE

MBI ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE ROLET E STRUKTURAVE SHËNDETËSORE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE PRANË QËNDRAVE SHËNDETËSORE/PIKAVE VERORE PËR SEZONIN TURISTIK



- VKM Nr. 419, datë 4.7.2018 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor"
- Urdhri Nr. 18, datë 17.01.2019 të MSHMS "Për Miratimin e Rregullores së Brendëshme për Mënyrën e Funksionimit dhe Organizimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor"
- Urdhri Nr. 116, datë 01.03.2024 të MSHMS, ndryshuar me Urdhrin 116/1, datë 02.05.2024 "Për disa ndryshime në Urdhrin Nr. 116, datë 01.03.2024 "Për marrjen e masave për fillimin e sezonit turistik veror 2024"
- Udhëzimi i MSHMS Nr. 156, datë 26.03.2024 "Mbi organizimin, funksionimin dhe procedurat e ofrimit të shërbimit pranë qendrave shëndetësore verore për sezonin turistik 2024", ndryshuar me udhëzimin Nr. 292, Datë 24.05.2024, "Për disa shtesa ndryshime në udhëzimin Nr. 156, datë 26.03.2024 "Mbi organizimin, funksionimin dhe procedurat e ofrimit të shërbimit pranë qendrave shëndetësore verore për sezonin turistik 2024"



TABELA E PËRMBAJTJES

- 1** Shërbimet dhe procedurat mjekësore bazë që duhet të ofrojë QSH/Pika verore
- 2** Detyrimet e DROSHKSH dhe NJVKSH që mbulon QSH/Pikën Verore në ofrimin e shërbimeve shëndetësore
- 3** Detyrimet e QSH verore/ Mjekut që ofron shërbime mjekësore në QSH/Pikën Verore në zonën e mbulimit
- 4** Mjeku që ofron shërbime mjekësore pranë QSH/Pikës verore




TABELA E PËRMBAJTJES

- 5** Detyrimet e infermierit të kontraktuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në QSH/Pikë verore
- 6** Detyrat dhe përgjegjësitë e shoferit të ambulancës
- 7** Detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të shërbimit mjedisor (sanitare
- 8** Hyrja në fuqi dhe zbatimi



SHËRBIMET DHE PROCEDURAT MJEKËSORE BAZË QË DUHET TË OFROJË QSH/PIKA VERORE



- Vizitë të përgjithshme mjekësore
- Kujdesi për rastet e urgjencës
- Mjekim dhe trajtim plage/Procedura dhe manipulime mikrokirurgjikale
- Procedura mjekësore diagnostikuese dhe trajtuese përfshirë injeksione të ndryshme, etj.
- Këshillim, Edukim dhe Promocion Shëndetësor pranë QSH/Pikës verore.
- Kujdes parandalues më qëllim minimizimin dhe luftimin e përhapjes së infeksioneve në popullatën e zonës së mbulimit





DETYRIMET E DROSHKSH DHE NJVKSH QË MBULON QSH/PIKËN VERORE NË

OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

- Drejtoritë Rajonale në bashkëpunim me Njesitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, marrin të gjitha masat për sigurimin e standardeve dhe mjediseve për ofrimin në vazhdimësi të shërbimit shëndetësor në plazhet dhe pikat turistike në territorin që administrojnë.
- Njesia Vendore e Kujdesit Shëndetësor është institucioni i drejtpërdrejtë përgjegjës për garantimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës, pajisjeve dhe sistemeve nga ana e Qendrës Shëndetësore/Pikës verore.
- Njesia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, në zbatim të Udhëzimit Nr. 156, Dt.26/03/2024 të MSHMS i ndryshuar, lidh kontratën e punës me stafin e emëruar pranë QSH/Pikës Verore në të cilën përcaktohen përgjegjësitë e shërbimit dhe detyrimet disiplinore që duhen zbatuar nga stafet gjatë ofrimit të shërbimeve në QSH/Pikë. Pjesë integrale e kësaj kontrate është edhe drejtori i QSH që mbulon Qendrën verore/Pikën verore.
- QSH që mbulon QSH/Pikën verore siguron sasinë e duhur të barnave, materialeve dhe pajisjeve mjekësore në bashkëpunim me NJVKSH, DROSHKSH dhe ofruesit e shërbimit spitalor në varësi të OSHKSH për gjatë të gjithë sezonit turistik veror të përcaktuar.
- QSH që mbulon Qendrën verore/Pikën verore në bashkëpunim dhe nën monitorimin e NJVKSH-së, pas tërheqjes së barnave dhe materialeve mjekësore, siguron dërgimin e tyre pranë QSH-re/Pikës verore.





DETYRIMET E DROSHKSH DHE NJVKSH QË MBULON QSH/PIKËN VERORE NË

OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

- Gjatë gjithë periudhës së sezonit veror, NJVKSH në bashkëpunim me QSH-re mëmë monitoron në vazhdimësi administrimin e medikamenteve dhe materialeve mjekësore të QSH/pikave verore që ndodhen në territor dhe bazuar në rregullat e qarkullimit të brendshëm të medikamenteve/materialeve mjekësore merr të gjitha masat për qarkullim në rastet e mungesave të ndonjë medikamenti në QSH/Pikat verore. Bashkëpunimin për raste të tilla NJVKSH-ja e shtrin edhe me NJVKSH-të e tjera në rajon si dhe më gjerë ndërmjet rajoneve. DROSHKSH koordinon dhe mbështet të gjithë procesin në vazhdimësi.
- NJVKSH-ja në bashkëpunim me QSH që ka nën administrim QSH verore/Pikën merr të gjitha masat për sigurimin e dokumentacionit standart të domosdoshëm mjekësor që do të administrohet nga stafi i QSH/Pikës verore për evidentimin dhe dokumentimin e shërbimeve dhe procedurave mjekësore të ofruara.
- Njesia Vendore e Kujdesit Shëndetësor në respektim dhe zbatim të protokolleve dhe udhërrëfyesve për parandalimin e përhapjes së infeksioneve siguron për gjatë gjithë sezonit materialet e mbrojtjes vetjake për personelin e Qendrës/Pikës verore.
- NJVKSH-ja në bashkëpunim me QSH që ka nën administrim QSH verore/Pikën, siguron që QSH/Pika verore administron dhe zbaton në praktikë bazën ligjore të domosdoshme për ofrimin e shërbimeve shëndetësore.
- NJVKSH kryen monitorim ditor të aktiviteteve dhe ofrimit të shërbimeve për QSH/Pikat verore që ka nën administrim. Brenda datës 04.06.2024 përcakton dhe përcjell pranë DROSHKSH pikat fokale përgjegjëse në nivel NJVKSH për monitorimin ditor dhe raportimin e aktivitetit në QSH/Pikat verore. Brenda datës 04.06.2024, DROSHKSH njofton DQOSHKSH për personat/pikat fokale të përcaktuar për monitorim dhe raportim nga NJVKSH-të si dhe personat/pikat fokale të përcaktuara dhe nga vetë DROSHKSH.





DETYRIMET E DROSHKSH DHE NJVKSH

QË MBULON QSH/PIKËN VERORE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE


- NJVKSH-ja mbledh dhe përpunon aktivitetin javor të dërguar nga QSH/Pika verore dhe raporton informacionin për aktivitetet/procedurat e kryera pranë DROSHKSH /DQOSHKSH, çdo të Hënë brenda orës 10.00, bazuar në formatin standart të raportimit dërguar nga Drejtoria Qendrore e OSHKSH.
- NJVKSH dhe QSH-re duhet të sigurojnë që sinjalistika orientuese, afishimi i numrave të emergjencës dhe i masave parandaluese për kontrollet e infeksioneve të jenë prezent dhe në gjendje të mirë gjatë gjithë periudhës së funksionimit të Qendrës/pikës verore.
- NJVKSH dhe QSH-re, në përfundim të sezonit në mënyrë të menjëhershme, merr të gjitha masat për inventarizimin e menjëhershëm të medikamenteve dhe materialeve mjekësore të përdorura nga shërbimi shëndetësor pranë QSH/Pikës verore.
- NJVKSH dhe QSH-re, në përfundim të sezonit, merr të gjitha masat për inventarizimin, magazinimin, administrimin dhe ruajtjen e aparaturave/pajisjeve mjekësore dhe ato logjistike.
- DROSHKSH, në territorin e të cilave ushtrojnë aktivitetet QSH/Pikat verore gjatë sezonit turistik, ndjekin dhe monitorojnë në vazhdimësi zbatimin e këtij udhëzuesi nga NJVKSH/QSH-re dhe në informacionin javor të dërguar pranë DQOSHKSH të përshkruar në pikën 11 të këtij udhëzimi, paraqesin dhe problematikat e vërejtura në monitorimin e kryer për ofrimin e shërbimeve pranë çdo QSH-re/Pike verore.





DETYRIMET E MJEKUT QË OFRON SHËRBIME MJEKËSORE NË QSH/PIKËN VERORE NË ZONËN E MBULIMIT


- Mjeku dhe personeli tjetër i QSH/Pikës Verore në ofrimin e shërbimeve shëndetësore janë në varësi të drejtpërdrejtë kontraktuale dhe organizative nga Drejtori i Qendrës Shëndetësore në të cilën ka varësinë dhe Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor me të cilën lidh kontratën e shërbimit.
- Mjeku mirëpret, orienton dhe ofron shërbim shëndetësor për çdo pacient/pushues që paraqitet në QSH/pikën Verore duke dhënë përgjigje profesionale me mirësjellje dhe në respekt të plotë të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore.
- Mjeku i QSH/pikës verore dhe stafi infermieror, për shërbimet shëndetësore që ofrojnë gjatë gjithë sezonit turistik, respektojnë Statusin e QSH, Rregulloren e QSH-së që i mbulon, Kontratën që QSH-re ka lidhur me FSDKSH, paketën bazë të shërbimeve në KSHP, standardet operacionale të punës (SOP) dhe protokollat e praktikës klinike në shërbimin e emergjencë - urgjencave mjekësore si dhe çdo bazë ligjore të funksionimit dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore.
- Mjeku i QSH/pikës verore në zonën që mbulon kryen vizitën, mjekimin, shërbimin e urgjencës dhe çdo procedure mjekësore falas për të gjithë pushuesit vendas dhe të huaj. Shërbimi mjekësor ofrohet si në QSH/Pikën Verore ashtu dhe në plazhe, vende pushimi, ambiente publike, etj që lidhen me zonën e mbulimit.





DETYRIMET E MJEKUT QË OFRON SHËRBIME MJEKËSORE NË QSH/PIKËN VERORE NË ZONËN E MBULIMIT


- Stafi i QSH/Pikës verore pranon dhe bashkëpunon me ekipet e NJVKSH/OSHKSH për monitorimin/kontrollin e aktiviteteve dhe shërbimeve që ofron si dhe raporton periodikisht pranë QSH-re dhe NJVKSH-së përkatëse për aktivitetin që ofron duke ju përmbajtur standardeve të dërguara nga OSHKSH për këtë qëllim.
- Mjeku i QSH/pikës verore, duhet të mbajë dhe administrojë në ambjentet e ofrimit të shërbimeve barnat dhe materialet e mjekimit të dërguara nga QSH që mbulon QSh/pikën verore sipas përcaktimeve në akte ligjore dhe administrative. Mjeku/stafi mjekësor i QSH/Pikës verore dokumenton/përshkruan në regjistër dozën dhe sasinë e medikamentit të aplikuar/të dhënë pacientët të paraqitur/trajtuar pranë ambienteve të shërbimit.
- Në mënyrë periodike (maksimalisht 2 javore), personeli infermieror i QSH/pikes verore në bashkëpunim me drejtorin dhe ekonomistin e QSH që e mbulon bëjnë inventarizimin e barnave dhe materialeve të mjekimit në QSH/pikën verore. NJVKSH në mënyrë periodike monitoron inventarizimet e kryera nga QSH dhe pika verore.





DETYRIMET E MJEKUT QË OFRON SHËRBIME MJEKËSORE NË QSH/PIKËN VERORE NË ZONËN E MBULIMIT


- Ofrimi i shërbimit të urgjencës jepet bazuar, në Ligjin Nr. 147/2014 “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”, apo çdo akt ligjor e nënligjor në funksion të ofrimit të këtij shërbimi duke dokumentuar shpenzimet për mbulimin e këtij shërbimi për çdo rast. Stafi i QSH/Pikës verore bashkëpunon ngushtësisht me shërbimin e urgjencës kombëtare dhe për referimin e rasteve në drejtim të spitaleve rajonal/bashkiak në zonën e mbulimit.
- Mjeku i QSH/pikës verore njuh, zbaton politikat dhe procedurat e shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës, duke përfshirë procedurat mbi mirëmbajtjen/mirëadministrimin e dokumentacionit, monitorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe aparaturave mjekësore/diagnostikuese dhe mobiljeve të QSH/Pikës verore ku ushtron përgjegjësinë e tij.
- Mjeku i QSH/pikës verore siguron që veprimet e kryera të mbështeten në barazi, diversitet dhe të drejtat e pacientit, duke respektuar privatësinë, dinjitetin, nevojat dhe besimet e pacientëve dhe të afërmve të tyre.





DETYRIMET E MJEKUT QË OFRON SHËRBIME MJEKËSORE NË QSH/PIKËN VERORE NË ZONËN E MBULIMIT

- QSH/Pika verore harton grafikun javor të mbulimit të shërbimit për mjekun dhe infermierin dhe e dërgon atë pranë QSH/NJVKSH-së. Grafiku i shërbimit vendoset në vend të dukshëm në ambientet e shërbimit.
- Qendra Shëndetësore, duhet të ruajë dhe të mirëmbajë të gjitha pajisjet, aparaturat mjekësore që ka në dispozicion, si dhe është përgjegjëse për mbrojtjen nga dëmtimi/vjedhja apo humbja e shkaktuar nga pakujdesia dhe neglizhenca.
- Stafi i QSH-re/Pikës verore respekton plotësisht orarin e punës, rregulloren e brendshme të QSH-re/Pikës verore dhe grafikun ditor/javor të punës.





MJEKU QË OFRON SHËRBIME MJEKËSORE PRANË QSH/PIKËS VERORE DUHET TË JETË I AFTË



- Të zbatojë kodin e deontologjisë mjekësore në kushtet e gjendjeve së urgjencës;
- Të vlerësojë klinikisht gjendjen dhe nevojat e pacientit, që kërkon ndihmë urgjente;
- Të marrë anamnezën dhe të kryejë ekzaminimin fizik për të përcaktuar saktë diagnozën e gjendjeve/rasteve të urgjencës;
- Të japë ndihmën e parë, stabilizojë e trajtojë rastet e zakonshme të urgjencës
- Të menaxhojë rastet urgjente jashtë QSH-së/Pikës verore (në plazh dhe në ambientet publike të zonës së mbulimit);
- Të menaxhojë e trajtojë dhimbjen, djegiet dhe plagët e vogla, laceracionet e thjeshta dhe infeksionet urgjente, jo kërcënuese për jetën;
- Të referojë pranë spitaleve Rajonale/Bashkiake rastet urgjente që rrezikojnë jetën e pushuesit/pacientit si dhe rastet që kërkojnë trajtim të mëtejshëm të specializuar;





MJEKU QË OFRON SHËRBBIME MJEKËSORE PRANË QSH/PIKËS VERORE DUHET TË JETË I AFTË



- Të kryejë manovrat e ringjalljes zemër mushkëri në rast të traumave apo në kërcënimet e jetës me natyrë jo traumatike tek foshnjat, fëmijët dhe të rriturit;
- Të administrojë mjekimet dhe injeksionet i.v. për stabilizimin e urgjencave (ndihma e parë), që rrezikojnë jetën e pacientit;
- Të administrojë mjekimet dhe injeksionet i.v. për menaxhimin e përkeqësimeve të astmës, dehidrimit, konvulsioneve, frakturave, plagëve;
- Të menaxhojë plagët e thjeshta;
- Të organizojë transportin e pacientëve me trauma/politrauma në përputhje me kushtet specifike të situatës dhe të pacientit;
- Të zbatojë parimet bazë të menaxhimit mjekësor të incidenteve të dëmtimit në masë dhe katastrofave;
- Çdo detyrë tjetër që i lind në zbatim të bazës ligjore në fuqi për ofrimin e shërbimit shëndetësor si dhe që i ngarkon Drejtori i QSH nën varësinë e të cilës është QSH/pika verore.





DETYRIMET E INFERMIERIT TË KONTRAKTUAR NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE NË QSH/PIKË VERORE


- Mirëpret, orienton dhe ofron shërbim për çdo pacient/person që paraqitet në shërbimin ambulator duke dhënë përgjigje me mirësjellje, korrektësi dhe në mënyrë të kuptueshme për qytetarët;
- Sqaron kërkesat e pacientëve/pushuesve si dhe merr dhe transmeton mesazhet e lëna prej tyre;
- Zbaton parimet e humanizmit dhe etikës mjekësore;
- Infermieri punon nën drejtimin dhe kontrollon nga Mjeku i QSH/Pikës verore në zbatim dhe të hierarkisë së institucionit. Gjithashtu ai është në varësinë direkte të kryeinfermierit të QSH në varësinë e të cilës është pika verore (ose personit të ngarkuar me detyrat e kryeinfermierit)
- Komunikon në mënyrë efektive me pacientët/pushuesit dhe familjarët, duke njohur nevojat e tyre për shërbim mjekësor të kërkuar;
- Përgatit pacientin/pushuesin për vizitë/ekzaminim, bashkëpunon me Mjekun për vizitën, duke zbatuar porositë që i jep mjeku për vizitën;
- Kujdeset në veçanti për një komunikim efektiv me pacientët në situata të veçanta klinike;





DETYRIMET E INFERMIERIT TË KONTRAKTUAR NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE NË QSH/PIKË VERORE

- Identifikon nevojat e pacientit, plotëson kartelën e kujdesit infermieror si dhe çdo dokumentacion klinik që kërkohet;
- Ndhmon pacientin që të ambientohet kur paraqitet në QSH/Pikë verore dhe të jetë i gatshëm ndaj çdo momenti e situatë që mund të krijohet;
- Ndhmon mjekun në plotësimin e dokumentacionit mjekësor të tilla si: regjistrin e vizitave; regjistrin e trajtimeve të rasteve urgjente dhe të shpenzimeve të barnave dhe materialeve mjekësore. Përgjigjet për plotësimin e saktë të dokumentacionit, nxjerrjen e të dhënave statistikore periodike dhe raportimin e aktiviteteve;
- Përgjigjet për kontrollin dhe verifikimin e furnizimit me barna materiale mjekësore si dhe bën kërkesat përkatëse pranë QSH nën varësinë e të cilës është, duke siguruar gjithmonë mbulimin e sasisë së duhur për minimalisht 5 ditë.
- Mban në kushtet e duhura higjienike Qendrën Shëndetësore/Pikën Verore.
- Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga mjeku, kryeinfermieri dhe drejtori i QSH në varësi të cilës është QSH/pika verore.



DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E



SHOFERIT TË AMBULANCËS

- Shoferët nga ana teknike kanë varësi direkte nga Mjeku i turnit dhe drejtori QSH në varësi të së cilës është QSH/pika verore.
- Është pjesë e grupeve të dhënies së ndihmës së parë në terren, dhe si i tillë angazhohet për të ndihmuar fizikisht personelin mjekësor të DHNP.
- Shoferi i autoambulances është përgjegjës për gadishmërinë e automjetit në çdo kohë dhe transportimin e pacientëve dhe personelit në destinacionin e duhur.
- Kryen të gjitha shërbimet e vogla të automjetit që i takojnë vetë shoferit dhe që nuk ka nevojë për specialist.
- Në bashkëpunim me ekonomistin e QSH në varësi të së cilës është QSH/pika verore përgjigjet për gadishmërinë teknike të automjetit, për furnizimin me karburant dhe gadishmërinë e aparaturave mjekësore të automjetit (si oksigjen, etj).
- Mban përgjegjësi për humbjen dhe/ose zëvendësimin e materialeve të inventarizuara në autoambulancë. Në cdo konstatim të mësipërm, shoferi i turnit mban procesverbal për humbjen dhe/ose zëvendësimin e pajiseve në autoambulancë dhe e paraqet atë pranë ekonomistit dhe drejtorit të QSH në varësi të së cilës është QSH/pika verore.



DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E



SHOFERIT TË AMBULANCËS

- Dorëzon automjetin në parkimin e caktuar në territorin e QSh/pikes verore menjëherë me mbarimin e turnit të shërbimit të tij dhe e nxjerr automjetin vetëm kur ka turnin e shërbimit ose për urgjenca me porosi të mjekut të QSH/pikes verore dhe të drejtuesve të institucioneve.
- Gjatë riparimit të automjetit shoferi e dorëzon atë të pastruar dhe të gatshëm për servis.
- Shoferi dorëzon të plotësuar dhe të firmosura fletë udhëtimet në afatet e përcaktuara në urdhrat e brendshëm të lëshuara nga Drejtoria për këtë qëllim.
- Transportimi i pacienteve në spital nuk duhet të bëhet pa personel mjekësor shoqërues.
- Mban përgjegjësi për përdorimin me efikasitet të karburantit dhe mos shpërdorimin e tij. Respekton urdhrat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta.
- Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga Mjeku i QSH/pikes verore dhe Drejtori i QSH nën varësinë e të cilës është QSH/pika verore




DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E



PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT (SANITARE)

- Sanitarja përgjigjet për sigurimin e higjienës dhe pastërtisë të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të QSH/pikes verore.
- Sanitarja ka varësi direkte nga infermieri dhe mjeku i QSh/pikes verore dhe në përditshmërinë e proceseve të punës mbikëqyret nga infermieri i shërbimit.
- Sanitarja mirëmban të gjitha pajisjet e QSH/Pikës verore sikurse janë: aparaturat e ndryshme, shtretërit, dhe materialet e tjera ndihmëse të QSH/Pikës verore.
- Sanitarja përgjigjet dhe për rregullin dhe qetësinë në QSH/Pikën verore. Kur konstaton grumbullime vizitorësh njofton infermierin e turnit.
- Sanitaria pastron dhe lan të gjitha ambientet, dhomat e triazhit dhe të observimit, komodinat, dritaret, muret, korridoret, etj. Bën pastrimin dhe larjen e banjove sa herë që është e nevojshme.
- Grumbullon dhe largon mbeturinat nga QSH/Pika verore nëpërmjet rrugëkalimeve të caktuara për këtë qëllim dhe i çon mbetjet e rrezikshme spitalore në kontenjeret e posaçëm të përcaktuar për hedhjen e mbetjeve të rrezikshme ndërsa ato urbane hidhen pranë koshit të mbetjeve urbane.
- Kryen dizinfektimin e ambienteve, shtretërve të pacientëve, banjove, etj.



DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E



PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT (SANITARE)


- Njeh dhe zbaton manualin e pastrimit dhe dezinfektimit të QSH/Pikës verore.
- Komunikon me të sëmurët dhe familjarët vetëm për problemet që lidhen me punën e saj.
- Sanitarët e kane të ndaluar t'i kryejnë shërbime personale pacienteve (si larje pacientesh, ndërrim qese urinë, ushqyerje, shoqërim, etj).
- Ndhmon infermierët kur është e nevojshme, për të sëmurët rëndë për kryerjen e nevojave të tyre fiziologjike në shtrat ose i shoqëron ato për në tualet, së bashku me infermierin.
- Për çdo problem që konstaton vë në dijeni infermierin e turnit dhe kryeinfermierin (personin e ngarkuar me këtë detyrë) në QSH në varësinë e të cilës është QSH/pika verore.
- I përmbahet Kodit të Sjelljes të QSH, duke respektuar etiken në lidhje me paraqitjen e jashtme dhe respektimin e uniformës.
- Respekton urdhrat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta.
- Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga Drejtori i QSH, kryeinferieri, mjeku dhe infermieri i turnit.





HYRJA NË FUQI DHE ZBATIMI

- Ky udhëzim hyri në fuqi më 1.6.2024.
- Ngarkohen QSH-re/Pikat verore, QSH-re që mbulon QSH/Pikën verore, Njesitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor që kanë nën varësi pikat verore, DROSHKSH dhe Drejtoria Qendrore e OSHKSH për zbatimin me përgjegjësi të këtij udhëzimi.





OSHKSH

Operatori i Shërbimeve
të Kujdesit Shëndetësor

#SHËNDET

#SHËNDET

KONTAKTO:



oshksh.gov.al



info@oshksh.gov.al



Rr. "Reshit Petrela", Tiranë